



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 26 Datë 10. 04. 2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË REZERVËS UJORE PËR ENERGJI  
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “Vellazeria ” Sh.p.k**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”,të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni , me propozim të A.B.U Drin- Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore , pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates , Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**Vendosi:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**Vellazeria” Sh.p.k** me administrator **Z.Dem GAXHA** , për përdorim të rezervës ujore **Përroi Skatines e Lugut te Kamit me derdhje ne liqenin e Fierzes** , degë e Lumit **Drin** , për prodhim energjie elektrike në Helshan ,Njësia Administrative Golaj-Krume , **Bashkia Has , Qarku Kukes** .  
Sipas studimit të paraqitur nga subjekti , **HEC Helshan** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes Nr1: X1 – 44 39 476 ; Y1 – 46 79 843 ; Z1 – +351.0 m  
Koordinatat e veprës së marrjes Nr.2: X2 – 44 38 616 ; Y2 – 46 79 012 ; Z2 – +351.5 m  
Koordinatat e godinës së centrali: X – 44 39 987 ; Y – 46 77 879 ; Z – +297 m;  
Koordinatat e pikes së shkarkimit : X – 44 39 987 ; Y – 46 77 879 ; Z – +297 m;  
Prurja mesatare e përroit: Q1mes= 1.65 m<sup>3</sup>/sek; Q2mes= 0.1 m<sup>3</sup>/sek;  
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 2.75 m<sup>3</sup>/sek;  
Prurja ekologjike: Q ekol= 0.1 m<sup>3</sup>/sek;  
Prurja që shkarkohet: Q= 2.75 m<sup>3</sup>/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të rezerves ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETARI**

**Martin PLLUMBI**

**KRYETARI**

**Paulin RADOVANI**

